



UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 858 Prot.

Durrës, më, 19 / 5 / 2023

V E N D I M

Nr. 30 Datë 19 / 5 2023

"Për miratimin e nivelit të pagave të personelit akademik sipas VKM nr.243, datë 20.04.2023 "Për disa ndryshime në VKM nr.748, date 11.06.2009 "Për trajtimin me page dhe shtesa mbi page të punonjësve të personelit akademik të institucioneve të arsimit të lartë" në Universitetin "Aleksandër Moisiu" Durrës"

Në mbështetje të Ligjit nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", ligjit nr. 84/2022 "Për buxhetin e vitit 2023", udhëzimit të përbashkët nr.20, datë 20.09.2019 të MASR dhe MFE "Për skemën dhe zbatimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor", VKM nr.243, datë 20.04.2023 "Për disa ndryshime në VKM nr.748, datë 11.06.2009 "Për trajtimin me page dhe shtesa mbi page të punonjësve të personelit akademik të institucioneve të arsimit të lartë", të nenit 14 pika 2 të Rregullores Financiare të Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës, vendimit të Senatit Akademik nr.25, datë 08.15.2023, relacionit të Administratorit nr.713, datë 27.04.2023, Bordi i Administrimit,

V E N D O S I:

1. Miratimin e nivelit të pagave të personelit akademik të Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës", në kufirin maksimal të tyre sipas lidhjes nr.1 "Strukturat dhe nivelet e pagave për punonjësit e personelit akademik në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë", Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.243, datë 20.04.2023 "Për disa ndryshime në VKM nr.748, datë 11.06.2009 "Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të personelit akademik të institucioneve të arsimit të lartë" pika 2b.
2. Burimi i financimit mbi kufirin minimal deri në kufirin maksimal do të përballohet nga të ardhurat që realizon UAMD.
3. Efektet financiare fillojnë nga data 1 prill 2023.
4. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi: Administratori, Drejtoria e Administrimit Financiar dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Juridike, pas miratimit nga ana e Senatit Akademik dhe Bordit të Administrimit të ndryshimeve në vendimet përkatëse për detajimin e përdorimit të të ardhurave.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT

Ada ALIAJ

